



RAPORT I PJESSHËM MONITORIMI I PROCESIT TËHARTIMIT, PUBLIKIMIT DHE KORRIGJIMIT TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE NË NJËSITË ADMINISTRATIVE TË BASHKISË TIRANË

Gjatë muajit Prill 2019, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) ndërmori një mision monitorues të 8 (tetë) Njësive Administrative të Bashkisë Tiranë. **Njësitë Administrative të monitoruara janë: Nr. 3, Nr. 4, Nr.5, Nr. 6, Nr. 7, Nr. 8, Nr. 9, Nr. 10.** Objekt i këtij monitorimi ishte verifikimi i procesit të hartimit, publikimit dhe korrigjimit të listave të zgjedhësve. Vëmendje e veçantë në këtë monitorim ju kushtua publikimit të ekstraktit të përbërësve zgjedhorë, njoftimit me shkrim të zgjedhësve në banesa, akordimit të fondit nga ana e Ministrisë përgjegjëse për gjendjen civile etj.

Për realizimin e këtij monitorimi, vëzhguesit e autorizuar të KShH-së morën takim me Administratorët e Njësive Administrative ose personat e autorizuar prej tyre, personelin përgjegjës të Zyrës së Gjendjes Civile, u panë nga afër listat zgjedhore si dhe u regjistruan me fotografi në ambientet ku ishin afishuar.

Në përfundim të këtij procesi monitorimi u arritën këto konkluzione:

1. Nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë më datë 05.11.2018 është dekretuar caktimi i datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.¹ Sipas këtij Dekreti, zgjedhjet do të zhvillohen më datë 30.06.2019. Përsa i përket publikimit të ekstraktit të përbërësve zgjedhorë, në përputhje me nenin 51, pika 4 të Kodit Zgjedhor (KZ), **brenda datës 04.12.2018**, zyrat e gjendjes civile, pas miratimit nga kryetari i njësisë vendore, printojnë dhe publikojnë ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të të gjithë shtetasve që kanë vendbanim në zonat e qendrave të votimit nën juridiksionin e çdo zyre. Pjesa më e madhe e njësive të monitoruara nuk i kanë njohur vëzhguesit me listat e publikuara periodikisht të zgjedhësve, ndërkohë që ky informacion është vënë në dispozicion vetëm në 2 Njësi Administrative. **Nga listat e vëna në dispozicion nga personeli i zyrës së gjendjes civile pranë Njësive Administrative Nr. 3 rezulton se publikimi i parë është realizuar më dt. 30.11.2018, ndërsa në Njësinë Nr.5 është publikuar më datë 05.12.2018. Sipas punonjësës së kontaktuar të gjendjes civile, kjo ishte data në të cilën lista ju ishte vënë në dispozicion nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.**
2. Në pikën 7 të dispozitës së sipërcituar të KZ është parashikuar detyrimi ligjor për publikimin në mënyrë periodike nga zyrat e gjendjes civile, çdo 30 ditë deri në shpalljen e listës së zgjedhësve. Në Njësitë Administrative të monitoruara janë vërejtur parregullsi në respektimin e këtij detyrimi ligjor. Në referim të kësaj dispozite nga ana e Zv/Ministres së Brendshme është lëshuar Udhëzimi nr. 295/1, datë 06.11.2018 “Për

¹ Nëpërmjet Dekretit nr. 10928.

procedurën e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore”². Në pikën 12 të këtij udhëzimi janë parashikuar datat **03.01.2019, 01.02.2019, 29.03.2019 dhe 28.04.2019. Muaji Shkurt 2019** konstatohet se është shoqëruar me vonesa në publikimin e ekstraktit të përbërësve zgjedhorë. Në Njësinë Administrative Nr. 5 vërehet se rifreskimi i ekstraktit është realizuar më dt. **05.02.2019** pra 4 ditë me vonesë, në shkelje të afatit të parashikuar në nenin 51, pika 7 të KZ. Gjithashtu muaji Mars në 2 njësitë administrative që kanë ofruar informacion të detajuar është shoqëruar me publikimin 2 herë brenda muajit të ekstraktit. Përkatësisht në Njësinë Administrative Nr. 3 vërehet publikimi në dt. **03.03.2019 dhe 29.03.2019**, ndërkohë në Njësinë Administrative Nr. 5 konstatohet publikimi i ekstraktit në dt. **04.03.2019 dhe 29.03.2019**. Sipas punonjësve të kontaktuar të gjendjes civile, këto (dhe të gjitha datat e tjera) ishin datat në të cilat listat ju ishin vënë në dispozicion nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Ky fakt i konstatuar cënon sanksionimin ligjor për përsëritjen e publikimit të ekstraktit çdo 30 ditë dhe në asnjë rast më shumë se 1 herë brenda muajit.

Gjithashtu, gjatë bashkëbisedimit të realizuar me Koordinatorin për Zgjedhjet pranë Njesisë Administrative Nr. 9 është pranuar se gjatë muajit shkurt nuk është respektuar afati i përcaktuar ligjor dhe ka pasur një vonesë prej 10 ditësh. Arsyeja e kësaj vonese nuk është referuar në mënyrë të qartë.

3. Në të gjitha Njësitë Administrative të tjera të monitoruara u konstatua se ekstrakti i fundit i përditësuar që rezultonte i publikuar mbante datën 29.03.2019, **me përjashtim të Njesisë Administrative nr. 4. Në këtë njësi, ekstrakti i përbërësve zgjedhorë të shtetasve nën juridiksionin e kësaj njësie ishte ripublikuar për herë të fundit më dt. 01.03.2019.**

4. Referuar procedurës së njoftimit me shkrim të zgjedhësve rezultoi se personeli i zyrës së gjendjes civile pranë Njesisë Administrative Nr. 8 nuk kishte dijeni nëse një individ përgjegjës ishte angazhuar për realizimin e kësaj procedure. Në mungesë të Administratores së Njesisë Administrative Nr. 3 dhe të Përgjegjëses së Zyrës së Gjendjes Civile, vëzhgueses së KShH-së nuk i është ofruar informacion lidhur me këtë procedurë. Në Njësinë Administrative Nr. 10, puna nuk kishte nisur ende për njoftimin me shkrim të zgjedhësve në banesa. Personeli përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile pranë kësaj Njesisë u shpreh se kjo vonesë vinte si rrjedhojë e mungesës së akordimit të fondeve nga ana e Ministrisë së Linjës dhe Bashkisë së Tiranës.


Në 4 prej Njësive Administrative të monitoruara, përkatësisht Nr. 4, 5, 7 dhe 9, nga ana e personelit përgjegjës të njësisë administrative dhe të zyrës së gjendjes civile është pranuar në mënyrë verbale se procedura e njoftimit të zgjedhësve në banesa ka nisur, por për vërtetimin e kësaj procedure në shkelje të nenit 52 të KZ dhe modeleve bashkëlidhur Udhëzimit nr. 295/1, dt. 06.11.2018, nuk u paraqit asnjë e dhënë. Nga ana e personelit të kontaktuar të Njësive Nr. 4 dhe 7 u paraqitën disa foto, në të cilat vërehej realizimi i procedurës së njoftimit të zgjedhësve me qëllim saktësimin e adresave të banimit.

5. Asnjëherë prej Njësive Administrative të monitoruara nuk rezulton që t’i jetë akorduar fondi për realizimin e njoftimit të zgjedhësve. Gjatë monitorimeve të realizuara jemi vënë në dijeni se ky fond i akordohet nga ana e Ministrisë së Brendshme, Bashkisë Tiranë dhe kjo e fundit realizon shpërndarjen pranë Njësive Administrative. **Vonesa në alokimin e këtij fondi nga ana e Ministrisë së Brendshme ka sjellë shkeljen e**

²Botuar në FZ nr. 169, datë 27.11.2018, fq. 11364.

parashikimit ligjor për lajmërimin me shkrim të qytetarëve në banesa nga ana e personave të ngarkuar, sipas nenit 52 të KZ. Gjithashtu, nga informacioni i marrë gjatë monitorimit të Njesisë Administrative Nr. 9, nga ana e juristes së institucionit, KShH është informuar mbi vakancën e krijuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile për një kohë të gjatë. Sipas saj kjo vakancë ka krijuar vonesa në hartimin e njoftimeve, që më pas do të përdorehin nga administratorët e lagjeve për të njoftuar zgjedhësit.

6. Me qëllim marrjen e një informacioni të detajuar për alokimin e këtij fondi, nga ana e vëzhgueses së KShH-së më dt. 11.04.2019 është tentuar që të merret takim me personat përgjegjës pranë Bashkisë Tiranë. **Në mungesë të dijenisë lidhur me organikën e institucionit nga ana e personelit të Receptonit dhe Zyrës së Informimit dhe Pritjes së Qytetarëve, si dhe inicimit të një proteste pranë Bashkisë Tiranë, vëzhgueses nuk i është ofruar asnjë informacion.**
7. Ekstrakti i përbërësve zgjedhorë rezulton të jetë afishuar vetëm në ambientet e njësive administrative të monitoruara. U konstatua se ekstraktet janë vulosur dhe nënshkruar në çdo faqe, nga ana e administratorëve të njësive administrative respektive dhe përgjegjësve të zyrës së gjendjes civile, **me përjashtim të ekstrakteve të afishuara në Njësinë Nr. 6. Aksesit i publikut në këto ekstrakte kufizohet vetëm gjatë orarit zyrtar të punonjësve të njësive, megjithëse në disa njësi u referua verbalisht se dera mund të hapet nga ana e rojes së sigurisë edhe pas këtij orari.**
8. Nga monitorimi rezultoi se ekstraktet janë lehtësisht të dallueshme dhe të lexueshme, në lartësi normale dhe janë të publikuara në ambientet e brendshme të institucionit. **Ambienti ku janë publikuar ekstraktet, në Njësitë Administrative Nr. 3 dhe 10, është shumë i vogël. Në Njësinë Administrative Nr. 10, mënyra e publikimit të ekstrakteve si një regjistër që duhet shfletuar e vështirësonte procesin e gjetjes së emrit nga ana e qytetarëve. KShH e vlerëson pozitivisht publikimin e këtyre ekstrakteve në ambientet e brendshme të institucioneve, me qëllim mbrojtjen nga kushtet atmosferike, por mungesa e masave mbrojtëse si p.sh. xham, në Njësinë Administrative nr. 8 dhe 3 i shndërron ato në objekte lehtësisht të dëmtueshme nga qytetarët.**
9. Nga informacionet e vëna në dispozicion nga personeli i Zyrës së Gjendjes Civile të Njesisë Administrative Nr. 4 dhe 9, kryesisht janë referuar problematika nga ana e qytetarëve lidhur me përbërës zgjedhorë si: pasaktësi në adresën e banimit ose ndryshim i saj nëpërmjet transferimit. **Nga ana e stafit të Njesisë Administrative Nr. 9 është ndërmarrë procedura e njoftimit të zgjedhësve për të realizuar saktësime përkatëse lidhur me përbërësit zgjedhorë, si adresa apo të dhëna personale identifikuese. Pas njoftimit dhe informimit mbi masën e sanksioneve administrative në rast mungese të saktësisht të këtyre të dhënave, është vërejtur një rritje e numrit të kërkesave të depozituara nga qytetarët. Objekt i këtyre kërkesave janë kryesisht saktësimi i vendbanimeve. Ndërkohë, është pretenduar se personeli i Njesisë Administrative Nr. 4 ka proceduar nëpërmjet njoftimit në rrugë jo zyrtare, me qëllim që qytetarët të paraqiten personalisht pranë zyrës së gjendjes civile për të depozituar kërkesën për ndryshim të përbërësit zgjedhor, në përputhje me nenet 53 dhe 54 të KZ. Deri tani nuk rezulton që të jetë depozituar asnjë ankim gjyqësor ndaj refuzimit të kërkesës për ndryshim të përbërësit zgjedhor.**



This report has been produced with the financial assistance of the Federal Republic of Germany. The implementation of this project is carried out by Albanian Helsinki Committee. The contents of this document are the sole responsibility of Albanian Helsinki Committee and can under no circumstances be regarded as reflecting the position of the Federal Republic of Germany